



01/Nr. 318 /2024
Data : 10.01.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dymbëdhjetë -XII- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 19.12.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2024.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
5. Draft plani lokal i veprimit për Barazi Gjinore .
6. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- objektivat e Kryetarit të Komunës janë Stimulim i nxënësve për regjistrim në shkollat profesionale me mbulim të shpenzimeve të udhëtimit dhe studentëve të suksesshëm me bursa studentore, Trajtimi i barabartë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe skemës sociale, Menaxhim cilësor dhe efektiv të buxhetit të komunës për vitin 2024, Vazhdim i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale, Qeverinë, IKSHPK, QKMF, etj , Transparencë digjitale për të gjitha aktivitetet në komunë dhe shpenzimet buxhetore, Krijimi i kushteve optimale për punë në çerdhen e fëmijëve, Vazhdim i përkrahjes së intitucioneve dhe aktiviteteve kulturore e sportive, Vazhdim i rritjes së shërbimeve në QKMF e AMF dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për qytetarët, Realizimi cilësor i të gjitha projekteve të planifikuara, Miratimi i PZHK-së dhe harta zonale e komunës, Informimi i qytetarëve dhe përkrahja për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas ligjit për legalizime, Përmbyllja e projektit CDI-KOMUNË-KRU “BIFURKACIONI” për rehabilitimin e Fabrikës së ujit në prockë të Dimcës si dhe vënia nën kontroll të ujit të pijshëm në Han të Elezit, Inkurajimi dhe mbështetja e qytetarëve për zhvillimin e aktiviteteve biznesore dhe përkrahja për hapje të bizneseve të reja, Vazhdimi i përkrahjes dhe stimulimi i fermerëve përmes subvencioneve, Bashkëpunim me komuna të ndryshme duke përfutuar nga eksperiencia e tyre dhe shembujt pozitiv, Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar me komuna , Bashkëpunim me institucione shtetërore, OJQ dhe institucione ndërkombëtare për prezentimin dhe afirmimin të komunës tonë. Digjitalizimi i Bibliotekës të qytetit të Hanit të Elezit, Përfundimi i investimeve në memorialin Bllaca 99, Krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe rekreative. Plani është i harmonizuar edhe me planifikimet buxhetore për vitin 2024.

Sherif Berisha thekson:- faqe numër dy objektivat janë për vitin 2024 por shënon viti 2023.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- te plani i këshillit komunal për siguri janë të paraparë aktivitetet, objektivat, periodha kohore, rezultate, përgjegjësia. Në plan te aktivitete janë të parapara të gjitha temat që do të diskutohen për vitin 2024.

Nora Xhoni thekson:- çështjen e qenve endacak ndoshta e keni diskutuar edhe pse zgjidhje nuk është duke u bërë ndër vite por a mendohet diçka me u bërë sepse është bërë rrezik për shkak se edhe nëpër oborre o vijnë.

Sevdi Dernjani thekson:- në takimet që i kam pasur Kryetari i Komunës që nuk ka pasur mundësi me shkuar e kam përfaqësuar unë dhe janë ngritur çështjet për trajtimin e qenve endacak por është një problem shtetërorë dhe nuk jemi tu mundur me i dhënë zgjidhje. Komuna ka kapacitet shumë të vogël për trajtimin e qenve endacak dhe shqetësimet që vinë nga qytetarët i përcjellim në organet kompetente që është qeveria në këtë rast.

Sherif Berisha thekson:- a ka diçka konkret rreth dukurive negative nëpër shkolla por edhe lojërat e fatit janë një dukuri shumë e rrezikshme dhe është mirë me pasur parasysh.

Sevdi Dernjani thekson:- për të gjitha dukuritë negative në lokalitetin tonë janë diskutuar edhe në nivel lokal por edhe në nivel qendrorë. Strategjia për rini kombëtare për vitin 2024 -2032 nuk janë kanë të parapara këto shqetësime por si komunë i kemi adresuar në takim lojërat e fatit , përdorimin e lëndëve narkotike si dhe rrezikshmëria e tyre. Tri çështjet të cilat i ka ngritur komuna jonë janë të përfshira në atë dokument.

Kryesuesi thekson:- është mirë të merren me rastet me kohë se ndoshta dikur bëhet vonë . E meta jonë në këtë rast që nuk po kemi rezultate është se po mbulohen rastet. Personat adekuat që janë për këtë punë duhet të merren me këtë çështje dhe besoj që do të ketë rezultat. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Draft plani lokal i veprimit për Barazi Gjinore .

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- në këtë vit i kam përkrahur dy sektorë të bujqësisë sektorin për perimtarin dhe sektorin e lavërtarisë. Shuma e mjeteve që janë dhënë nuk janë të mjaftueshme por këto janë mundësit tona buxhetore. Janë mbështetur 42 fermerë në shumë prej 8400 €, ndërsa pjesa e dytë është e serrave por ende ky proces nuk ka përfunduar por në momentin që do të përfundon do tu a sjellim një raport.

Sherif Berisha thekson:-sa i përket serrave nuk më është dukur e arsyeshme vazhdimi i afateve se nëse ka dështuar është dashur më mirë komuna me i paguar shpenzimet se sa me u tërhequr personat pasi kanë hyrë në listë.

Abduraman Bushi thekson:- janë dy arsye që janë shtyer, e para ka qenë se në afatin e parë neve na janë ndarë 60 serra, mirëpo kur është bërë tenderimi te shoqata çmimi prej 1400 € sa ka qenë sipas marrëveshjes, çmimi në tender ka rënë 1000 € dhe atëherë prej shoqatës na është lejuar që me rritur numrin nga 60 në 84 serra dhe na është dashur me shtyjë afatin për shkak se kemi pasur kërkesa. Pasi ka përfunduar procedura tre prej tyre në momentin e fundit janë tërhequr dhe pasi kishim kërkesa kemi kërkuar që të vazhdohet për plotësimin e atyre vendeve . Procedurat kërkojnë kohë sepse shoqata i ka procedurat e veta dhe besoj që javën e ardhshme përfundojnë procedurat dhe nga dita e ejte do të fillon montimi i tyre në teren.

Refet Kalisi thekson:- a është plotësuar numri.

Abduraman Bushi thekson:- numri është plotësuar.

U VOTU PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË BUJQËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- dekorimi i qytetit për festat e fundvitit 13.50 €, mendoj që është gabim.

Arsim Dernjani thekson:- nuk është gabim por vetëm e kemi lënë si kod.

Sherif Berisha thekson:- dekorimi i qytetit a është donacion apo prej komunës.

Arsim Dernjani thekson:- është donacion prej kompanisë “Sharrcem”.

Kryesuesi thekson:- sa i përket përbërjes së KPF-së ju e dini që kemi pasur një marrëveshje me grupet parlamentare, me rrotacion, andaj për mbledhje të kuvendit duhet të merret vendim që me u ndërruar.

Refet Kalisi thekson:-pasi që nuk paguhet për KPF anëtarja që do të më zëvendëson unë kërkoj që mos të ndryshohet përbërja e KPF-së.

Sherif Berisha thekson:- në buxhet a janë projektet të cilat i kemi votuar në kuvend , si është çështja me protokolet.

Lindita Ballazhi thekson:- ka ndryshime me kërkesë të Ministrive nëpër disa aktivitete të ndryshme por kufijtë buxhetorë nuk kanë ndryshuar por janë të njëjtit, pra stafi total 249, pagat dhe shtesat janë 1,075, 272.00 €, mallrat dhe shërbimet janë në shumë prej 524,500 .00 €, shpenzimet komunale 930,500.00 €, subvencionet dhe transferet 113,000.00 €, shpenzimet kapitale 543, 006.00 €. Siç e dini është ndryshuar statuti i komunës dhe drejtoria për arsim kulturë rini dhe sport është ndarë në dy drejtori dhe kemi bërë kërkesë për të krijuar një program për kulturën rinin dhe sportin veçmas. Në momentin që e kemi dorëzuar buxhetin në kuvendin komunal ende nuk ka qenë i krijuar kodi i kësaj drejtorie dhe nuk mundem unë vetë të krijoj kodë pro duhet nga ana e ministrisë së financave – departamenti i buxhetit ta krijohet dhe për gjatë muajit shtatorë ministria na e ka dërguar kodin përkatës dhe normalisht është planifikuar stafi për atë drejtori dhe është bërë harmonizimi i stafit. Propozimet të cilat janë miratuar në kuvend është dashur të i inkorporojmë në buxhet.

Sherif Berisha thekson:- është mirë që edhe kryesuesi i kuvendit ta jep mendimin e vetë se a është në dioni se ka shkuar tjetër buxhet në nivel qendrorë , kurse na kemi votuar diçka tjetër.

Lindita Ballazhi thekson:- unë vetëm sa e ceka që mjetet për drejtorinë e kulturës, rinisë dhe sportit të cilat ishin së bashku me drejtorinë e arsimit , se ministria nuk na e ka krijuar këtë drejtori sepse çdo drejtori e ka kodin e vetë , stafin e vetë , kategoritë e veta buxhetore , kështu që unë nuk kam mundur me shpik atë kodë për atë drejtori dhe atë e krijon ministria –departamenti i buxhetit. Në kuvend e përcjell buxhetin siç e planifikon por tani procedura vazhdon në ministri të financave nga analistët e buxhetit. Projektet të cilat janë miratuar në kuvend janë të njëjta dhe është dashur të bëjmë normalizim të shumave kurse kufijtë janë të njëjtë.

Ibadete Kalisi thekson:- në lagje të re ku është ndërtuar tretuari uji nuk po kalon kur po ka reshje të shiut për shkak se reshtka është shumë e vogël dhe është mirë të rregullohet.

Kryesuesi thekson:- unë kam reaguar me kohë dhe nuk është përfill reagimi.

Sherif Berisha thekson:- problemi me çështje të ujit po vazhdon dhe nuk e di a donë me u zgjedhur ndonjë herë sepse ujë nuk kemi. Kohët e fundit ka pasur reshje dhe uji ka ardhur i turbullt. E di që është bërë marrëveshja me kompaninë “Bifurkacioni” por komuna nuk mundet me mbetur pa përgjegjësi.

Arsim Dernjani thekson:- pardje kemi pasur takim me përfaqësuesit e kompanisë “Bifurkacioni dhe janë në fazën përfundimtare sepse i kanë mbetur edhe disa orëmatës me i vendosur por është problem se shumica në atë pjesën ku ju banoni jeni të kyçur të gjithë në gypin e vjetër dhe duhet të ndërprehet gypi i vjetër për me u këqyr në gyp të rijë. Përfaqësuesit e kompanisë “Bifurkacioni” potencuan se pasi të dalin instituti për konstatimin që është uji i pishëm kompania do të del me një shkresë që uji është i pishëm pastaj do të vendoset për çështje të pagesës.

Refet Kalisi thekson:- nëse është në gyp të vjetër ujë nuk duhet me pasur hiq por ujë ka.

Arsim Dernjani thekson:- në bazë të prononcimeve të përfaqësuesve të kompanisë unë e potencova.

Sherif Berisha thekson:- qytetarët ma kanë shprehur një shqetësim, bëhet fjalë për te shtëpia e z.Ismal Topojani dhe z.Xhemil Topojani është mirë të dilet në vend ngjarje dhe të shikohet kanalizimi se është zënë dhe balta vjen për rruge kur bien shi.

Refet Kalisi thekson:- shportat e mbeturinave në Han të Elezit janë katastrof edhe pse jeni munduar me i riparuar ata nuk riparohen më.

Arsim Dernjani thekson:- jemi duke pritur prej Giz-it një kamionet për kompaninë dhe shportat për mbeturina por nëse nuk e kryen deri në muajin mars Gizi do të shpallim procedurë prej komunës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:10.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

